

## Aneksi 7

### FTESË PËR OFERTË

**Emri:** Milieukontakt Shqipëri  
**Adresa:** Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion,  
Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri  
**E-mail:** [office@milieukontakt.org](mailto:office@milieukontakt.org)  
**Afati i dorëzimit të ofertës:** 7 prill 2024

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin “*Të rinjtë për një të ardhme të qëndrueshme*” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal.

#### Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 7 prill 2024, në adresën e e-mailit: [office@milieukontakt.org](mailto:office@milieukontakt.org) ose në adresën postare Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.

#### Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Milieukontakt Shqipëri do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktin sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i produktit	Ditë pune	Çmimi/njësi Me TVSH (ALL)
1.	Udhëzues mbi Objektivat e Zhvillimit të qëndrueshëm	10	
	<b>Totali</b>		

### **Specifikime të përgjithshme teknike:**

- Zhvillimi i metodologjisë për realizimin e një udhëzuesi mbi OZHQ-te
- Informacion i përgjithshëm mbi OZHQ. (Cfarë janë OZHQ, çfarë është zhvillimi qëndrueshëm, cili është statusi i shqipërisë, çfarë mund të bëhet më shumë, dhe si mund të kontribuojnë të rinjtë)
- Realizimi i kurrikulave mësimore për të rinjtë e shkollave 9 vjeçare që lidhen me OZHQ - 6,11,13, 15
- Ushtrime praktike dhe aksione konkrete në terren për të arritur OZHQ - 6,11,13, 15
- Eksperti do të ketë në dispozicion 10 ditë pune
- Ofrimi i këtij shërbimi kërkohet për periudhën **Prill-Qershor 2024**. Me Subjektin fitues do të lidhet një kontratë.

### **Kushte të përgjithshme:**

- 1) Subjekti ose personi fizik duhet të jetë i regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Preferohet subjekt ose person fizik që ushtrojnë ekspertizën e tyre në territorin e bashkisë Lushnje;
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email [office@milieukontakt.org](mailto:office@milieukontakt.org) brenda datës 7 prill 2024 ose në adresën postare Rr. 'Xhorxhi Martini', Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. **Nuk pranohen ofertat dorazi.**
- 4) Pagesa e subjektit/ personit fizik kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse ose subjekt i tatimit mbi të ardhurat 15% e cila do të zbritet si një tatim nga të ardhurat personale.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) CV ku të tregohen eksperiencat e mëparshme;
- 2) Ekstraktin e QKB në rastin kur është subjekt, ose ID në rastin e personit fizik;
- 3) Ofertën financiare për produktin sipas tabelës më sipër;
- 4) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.